

**Qendra për gazetari hulamtuese SCOOP Maqedoni**

# **RAPORTI**

**për rezultatet e projektit “Mbrojtja e të drejtave nëpërmjet  
gazetarisë hulamtuese”**

**Shkup, 8 Maj 2017**

## **HYRJE**

Politikanët në Maqedoni në vend se në parlament apo në debate publike televizive, të cilat në vitet e fundit janë shumë të rralla, gjithnjë e më shumë vendosin që përballjen përfundimtare ta kenë në sallën e gjyqit. Qindra gazetarë dhe media, politikanë, biznesmenë, profesorë, organizata joqeveritare, ndërmarrje publike, personalitete të estradës, por edhe qytetarë të cilët nuk janë persona publikë, vitet e fundit kanë kaluar nëpër korridoret e gjykatave duke e kërkuar drejtësinë. Ose kanë qenë të paditur ose kanë paditur për një fyerje ose një shpifje të shprehur, duke kërkuar që t'u paguhet një kompensim me të holla për reputacionin ose nderin e dëmtuar, ose kanë qenë në anën tjetër të kontestit gjyqësor - në rolin e të paditurve, me ç'rast është dashur nganjëherë ta paguajnë "trashë" atributin e tyre jo etik, të shprehur me zë të lartë kundër dikujt. Edhe pse gjykata për një pjesë të aktgjykimeve ka pasur parasysh që shumica e kompensimit me të holla (nga 6.000 deri në 20.000 denarë) të përcaktohet në përputhje me situatën ekonomike në vend, megjithatë ka edhe përjashtime ku ata që kanë humbur kontestin për shpifje dhe fyerje, kanë qenë të detyruar të paguajnë edhe më shumë se 150 mijë denarë. Sanksionet, përkatësisht gjrobat me të holla që i paguajnë për një rast i kanë sjellë mediat dhe në skajin e ekzistencës.

Në vendet e lira dhe demokratike, politikanët në parim nuk padisin gazetarët dhe mediat. Këtë mësim duhet ta mësojnë edhe politikanët e Maqedonisë. Ata qytetarë që duan të kryejnë funksione publike, duhet të dinë se kur do të zgjidhen në një funksion publik, do të ekspozohen ndaj kritikave më të madhe në opinion. Paditë për shpifje kundër gazetarëve duhet të jetë përjashtim, e jo rregull. Në vendet e lira, padi të tilla kundër gazetarëve ngrihen në situata të jashtëzakonshme kur një gazetar me qëllim të keq, pa baza dhe vazhdimisht përhap informacione të pasakta në opinion për një person me një qëllim të qartë për ta dëmtuar nderin dhe reputacionin e tij.

Edhe pse perceptimi në opinion është se mysafirë më të shpeshtë të gjykatave janë politikanët, biznesmenët, gazetarët, megjithatë shembujt e gjykatave e tregojnë të kundërtën. Një numër gjithnjë më i madh i kontesteve në mes të qytetarëve të cilët nuk janë persona publikë dhe kanë ndier "një dhembje shpirtërore" ose ua kanë prishur "gjumin", ose për shkak të fyerjes që ua kanë thënë fqinjët ose ish-partneri, ndonjë i afërm apo një koleg pune, u është rritur "tensioni". Motivet janë të ndryshme: hakmarrja, mosmarrëveshjet familjare, rivaliteti, përplasja politike. Në gjykatë përfundojnë edhe grindja e ndërsjellë fqinjësore apo mosdurimi në vendin e punës. Një nxitje shtesë për ngritjen e procedurave gjyqësore janë edhe kompensimet të konsiderueshme me të holla për të cilat shpresojnë paditësit.

## **QASJA METODOLOGJIKE**

Metodologjia e hulumtimit janë analizat e përmbajtjeve, statistika, intervistat, anketat. Ekipi ka vendosur hipoteza tematike të cilat gjatë procesit të hulumtimit janë të vërtetuara. Janë mbajtur edhe takime të rregullta javore të redaktorëve në të vilat janë bërë plane, janë shkëmbyer ide, janë përcaktuar drejtimet, janë zgjidhur dilema. Në bazën ditore janë bërë brifingje dhe analiza e punës së kryer.

Temat janë realizuar dhe publikuar në dy versione – atë të shkurtër dhe të gjatë. Janë bërë intervista dhe janë siguruar deklaratat nga tridhjetë profesorë, ekspertë, gazetarë. Është bërë kontakt edhe me avokatë dhe gjykatës të cilët temën "shpifje dhe fyerje" e kanë pjesë e preokupimit të tyre praktike dhe teorike të punës. Një pjesë e intervistave dhe deklaratave janë incizuar në audio dhe video, një pjesë janë audio incizime, ndërsa një pjesë janë cituar apo parafrazuar në formën e tekstit. Janë vënë edhe linqe me mundësi të prezantimit një pjese të

video intervistave të incizuara me qëllim të prezantimit të tyre integral, ndërsa teoria është ilustruar me prezantimin grafik të të dhënave statistikore, të marra nga gjykatat.

Për periudhën nga 15 nëntori 2016 deri më 15 maj 2017, janë realizuar dhe publikuar tri storje hulumtuese, duke përfshirë:

- 1. Padia si bazë për revanshizëm ndaj atyre që nuk kanë mendim të njëjtë**
- 2. Kush paraqitet më së shpeshti si paditës dhe i paditur në procedurat gjyqësore për një fjalë të shprehur publikisht nga viti 2011 e deri më tani?**
- 3. Sa qytetarë kanë kërkuar drejtësinë në gjykatat e huaja (Strasburg) dhe janë paditur për një fjalë të shprehur publikisht?**

Ekipin hulumtues të gazetarëve të SCOOP-it e përbëjnë Zoran Ivanov (Udhëheqës i projektit), Xhelal Neziri (redaktor), Aleksandar Bozhinovski (redaktor i faqes së internetit), Daniella Tërçevska (gazetare-redaktore) dhe Angella Petrovska (gazetare e re). Ekipi i ka hulumtuar, përpunuar, faktografuar dhe publikuar në produkte gazetareske.

Në bazë të ligjit për qasje të lirë deri në informata, janë dërguar pyetje dhe janë marrë përgjigje nga të gjitha 27 gjykatat themelore në vend, si dhe nga institucione të tjera, organizata joqeveritare, institucionet qeveritare dhe publike. Janë intervistuar edhe ekspertë, avokatë, gazetarë të cilët kanë qenë viktime të personave të fortë politikë dhe biznesmenë.

Tri storje me nga dy versione në gjuhën maqedonase dhe shqipe janë publikuar edhe në disa portale informative, si dhe në portalet e mediave tradicionale në vend.

## **REZULTATET E HULUMTIMIT**

Hulumtimi ka treguar se në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2016 janë parashtruar mbi 1.800 padi. Nga ato, rreth 1.000 sosh janë ngritur në vitin 2011 dhe 2012, para se të dekriminalizohet fyerja dhe shpifja, pas çka numri i padive është në rënie.

Qytetarët e Shkupit janë rekorderë sipas numrit të padive për fyerje dhe shpifje. Në Gjykatën Penale në vitin 2011 dhe 2012 janë ngritur 367 padi. Në Gjykatën Themelore Shkup 2, në periudhën prej vitit 2013 deri në vitin 2016 janë regjistruar gjithsej 497 lëndë. Janë paditur edhe politikanë edhe biznesmenë, por nga presioni nuk kanë shpëtuar as gazetarët. Ata paraqiten në cilësi të palëve në procedurat e 173 lëndëve. Gazetarët janë paditur madje në 117 lëndë, kanë vendosur të padisin në 17 lëndë, ndërsa paditen njëri-tjetrin madje në 39 lëndë.

Statistikat tregojnë se nga 20 gjykatat në vend, në periudhën nga viti 2011 e deri më sot janë ngritur mbi 30 procese gjyqësore, pikërisht për fyerje të shprehura në rrjetin më të njohur social Facebook. Vetëm në Gjykatën Themelore Shkup 2, në periudhën prej vitit 2013 deri në vitin 2016, janë regjistruar gjithsej 13 lëndë për vërtetimin e përgjegjësisë qytetare për fyerje dhe shpifje, të bëra nëpërmjet rrjeteve sociale. Nga këto, në 8 lëndë, palë në procedurë janë qytetarë dhe atë: në një lëndë është marrë vendim me të cilin kërkesa për padi konsiderohet e tërhequr, në një lëndë është marrë vendim me të cilin kërkesa për padi është refuzuar si e pabazë, 5 lëndë ende janë në procedurë, ndërsa një lëndë për të cilën është parashtruar ankesë është në Gjykatën e Apelit në Shkup.

Në Gjykatën e Kërçovës vitin e kaluar është regjistruar një rritje të numrit të padive për fyerje dhe shpifje. Kjo Gjykatë në vitin 2011 ka punuar vetëm në një lëndë për shpifje. Statistikat e kësaj gjykate tregon se në vitin 2013 nuk ka pasur asnjë lëndë të kësaj fushe, por në vitin 2015 ka filluar trendi i parashtrimit të sa

më shumë padive. Kështu, nga 2 padi në vitin 2014 numri padive është rritur në 16 për dy vitet e fundit.

Banorët e Dibrës, megjithatë, janë të liruar nga ky stres - vetëm një bashkëqytetar i tyre këtë vit ka vendosur që dhembjen shpirtërore ta “shërojë” në gjykatë.

"Rekorderë" sipas numrit të padive janë gjykatat e Strumicë, Kumanovës dhe Manastirit. Në qoftë se në Strumicë në vitin 2011 ka pasur gjithsej 56 padi për fyerje dhe shpifje, në vitin 2016 numri i kontesteve është reduktuar në 23. E ngjashme është situata edhe me gjykatat e tjera. Për shembull, në Kumanovë në vitin 2011 ka pasur madje 60 padi për shpifje dhe fyerje, që pas dekriminalizimit të parashtrihen 45 padi - por për një periudhë prej katër vitesh. Rënia më drastike e numrit të lëndëve që bëhen për fyerje dhe shpifje, para dhe pas dekriminalizimit, duket se është në Gjykatën e Manastirit - në qoftë se atje në vitin 2011 ka pasur 59 lëndë, në vitin 2013 – ka pasur vetëm tetë padi.

Edhe pse gjykatat në një pjesë të aktgjykimeve kanë marrë parasysh që sasia e kompensimit me të holla të lëvizet prej 6.000 deri më 20.000 denarë, të përcaktohet në përputhje me situatën ekonomike në vend, ka edhe përjashtime, ku ata që kanë humbur kontestin për shpifje dhe fyerje, kanë qenë të detyruar të paguajnë edhe mbi 150 mijë denarë.

Satisfaksioni, në pamundësinë që të gjendet në gjykatat vendore, është kërkuar edhe në Gjykatën e Strasburgut. Gjatë 15 viteve të fundit, në periudhën nga viti 1997 deri në vitin 2015 ka pasur gjithsej 719 ankesa në këtë gjykatë ndërkombëtare.

## **KONKLuzionet**

Paditë për fyerje dhe shpifje edhe më tej mbeten një mjet për t'i heshtur ata që nuk kanë mendim të njëjtë, me ç'rast në shënjestër më së shpeshti janë gazetarët dhe mediat. Kjo praktikë kontribuon për përkeqësimin e gjendjes me lirin e mediave në Republikën e Maqedonisë, kështu që rritet niveli i censurës dhe auto-censurës të mediave dhe gazetarëve.

Politikanët shpesh paraqiten si paditës të gazetarëve, por edhe të kundërshtarëve të tyre politikë.

Gjykata e Strasburgut ende nuk përdoret mjaft si një mjet për të kontestuar vendimin e gjykatave të Maqedonisë, edhe pse tri rastet nga Maqedonia që janë në procedurë, mund të thuhet se janë përpjekje pioniere për të depërtuar paditë për fyerje dhe shpifje në këtë gjykatë.

Për dallim nga praktika evropiane, në gjykatat e Maqedonisë rrallë mund të shihet një aktgjykim në arsyetimin e të cilit citohen qëndrimet e Gjykatës Evropiane.

Edhe rrjetet sociale, sidomos rrjeti i njohur Facebook, përdoret si një mjet për të drejtuar fyerje midis personave jo publikë, por edhe midis atyre publike.

Gjithnjë më aktuale bëhen rastet me fyerje të shprehura në rrjetet sociale. Janë shprehur shumë shpifje, kurse drejtësinë për fyerjet e shprehura nëpërmjet Facebook-ut më shumë se 30 qytetarë në vend e kanë kërkuar në gjykatë.